



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Praxhori @ Dibër
dhe mban nga dërguesi nr. 1259/1 prot. _____
datë 13.12.2022 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) _____

Konfirmim ligjshmerie vendimi 108, dt. 06.12.22

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot. 3682/1 datë 14.12.2022

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z Drejtorisë së Tatim-Taksare

-Znj/Z _____

-Znj/Z 24. KRYETARËSISË TË BASHKISË

-Znj/Z _____

me porosinë: _____

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë _____

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: _____


Peshkopi, më 17.12.2022

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR



Nr.1259/1 prot.

Peshkopi, më 13.12.2022

Lenda : Mbi verifikimin e ligjshmerisë të vendimit nr.108 date 06.12.2022

Drejtuar: BASHKISE DIBER

DIBER

Në mbështetje të ligjit *nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"*, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e bashkise Dibër , *Nr 108, datë 06.12.2022 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023"*, vendosa miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e zbatimit dhe respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e taksave vendore e problemeve të ngjashme me to, veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrative-ligjore e strukturave të posaçme të bashkisë Dibër .

P R E F E K T I
- Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 5492 Prot

Peshkopi, më 12.12 2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.108

Datë: 06.12.2022

“Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Dibër për vitin 2023 ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli



Kapaja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 108 Date 06.12 /2022

“Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Dibër për vitin 2023”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë” ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **06.12.2022**, me 22 vota pro, 0 kunder, 0 apstenim:

VENDOSI:

- I. Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të institucionit të Bashkisë Dibër.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të gjithë drejtoritë e tjera të Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
- IV. Vendimi u shpall me date **06.12.2022**.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02 datë 25 / 11 /2022

**“ PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN
2023”**

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ___/___/2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë” ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Kërkojmë:

- I. Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të institucionit të Bashkisë Dibër.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të gjithë drejtoritë e tjera të Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjës Taksave dhe Tarifave Vendore

Bujar Manja

Drejtore Taksave dhe Tarifave Vendore

Lorenc Cibaku

Përgjegjës Sektorit Juridik

Elona Lusha

KRYETARI I BASHKISË

Rahim Spahiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
PAKETA FISKALE 2023

